

L I G J Nr.8555, datë 22.12.1999

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ASISTENCËS ADMINISTRATIVE PËR PARANDALIMIN, ZBULIMIN DHE NDËSHKIMIN E SHKELJEVE DOGANORE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja e Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, Ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Shpallur me dekretin nr.2507, date 30.12.1999 te Presidentit te Republikes se Shqiperise Rexhep Meidani

MARRËVESHJE E ASISTENCËS ADMINISTRATIVE PËR PARANDALIMIN, ZBULIMIN DHE NDËSHKIMIN E SHKELJEVE DOGANORE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë, këtej e tutje do t'u referohemi si Palë Kontraktuese;

Duke konsideruar se shkeljet e legjislacionit doganor janë të patolerueshme për interesat e tyre ekonomike, tregtare, fiskale, shoqërore, kulturore, industriale dhe bujqësore; Të bindur se aksionet kundër shkeljeve doganore mund të bëhen më efektive me anë të kooperimit të ngushtë të dy administratave doganore;

Duke konsideruar rëndësinë e llogaritjes së saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera mbi importet ose eksportet dhe të të qënies së sigurtë se masat e duhura merren në drejtim të ndalimeve, kufizimeve dhe kontrolleve, ku këto të fundit përfshijnë edhe kontrollin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe rregulloreve për mallrat e falsifikuara dhe markat tregtare të regjistruara;

Duke konsideruar se trafiku me drogat narkotike dhe substancat psikotrope paraqet rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

Duke iu referuar Konventës së Kombeve të Bashkuara, të 20 dhjetorit 1998, për luftën ndaj trafikut të jashtëligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, përfshi këtu edhe çfarë paraqitet në anekset e Konventës së sipërpërmendur, të amenduar dhe paparagjykuar ndonjë amendament tjetër të mundshëm që mund të aprovohet brenda kompetencave të Grupit të Përbashkët të Vazhdimësisë;

Duke iu referuar instrumenteve përkatëse të Këshillit të Kooperimit Doganor, në veçanti, rekomandimeve mbi asistencën administrative reciproke të 5 dhjetorit 1953; Ranë dakord për sa më poshtë vijon :

KAPITULLI I

Përcaktime

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje :

a) "legjislacion doganor" do të thotë ligjet dhe rregulloret që janë të detyruara për t'u zbatuar nga të dy Administratat Doganore në lidhje me: - importimin, eksportimin, tranzitimin dhe magazinimin e mallrave, kapitaleve, përfshi edhe mjetet e pagesës; - mbledhjen, garantimin dhe ripagesën e detyrimeve dhe taksave për importet dhe eksportet; - masat ndaluese, kufizuese dhe kontrollet, përfshi dhe këmbimin e ligjeve për kontrollet ; - luftën kundër trafikut të jashtëligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope ;

b) "Administratë Doganore" do të thotë Administrata Doganore Italiane së bashku me Guardia di Finanza (Rojen Financiare), për Republikën e Italisë dhe për Republikën e Shqipërisë, Administrata Doganore e Republikës së Shqipërisë, që është kompetente për zbatimin e dispozitave të përmendura në paragrafin a) të kësaj Marrëveshjeje;

c) "shkelje doganore" do të thotë çdo shkelje ose tentativë për shkelje të legjislacionit doganor;

d) "detyrimet doganore dhe taksat mbi/për importet dhe eksportet" do të thotë detyrimet doganore për eksportet dhe importet, si dhe të gjitha detyrimet, taksat, tatimet e tjera që mblidhen në lidhje me importin apo eksportin, përfshi për Republikën e Italisë, detyrimet dhe taksat që caktohen nga organet kompetente të Bashkimit Europian;

e) "person" do të thotë çdo person fizik ose person juridik;

f) "të dhëna personale" do të thotë çdo informacion që i referohet një qënieje njerëzore të caktuar apo të identifikueshme;

g) "droga narkotike dhe substanca psikotrope" do të thotë të gjithë produktet që përshkruhen në Konventën e Vjenës të 20 dhjetorit 1998, përfshi edhe ato të përcaktuara në anekset e Konventës në fjalë.

KAPITULLI II

Fushëveprimi i Marrëveshjes

Neni 2

1. Palët Kontraktuese, me anë të Administratave të tyre Doganore, do të japin asistencë administrative reciproke me kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, në drejtim të zbatimit të rregullt të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, zbulimin dhe luftën kundër shkeljeve doganore.

2. E gjithë asistenca, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, do të jepet në përputhje me legjislacionin kombëtar, dispozitat administrative dhe brenda kufijve të kompetencave të asaj Administrate Doganore dhe burimeve në dispozicion të saj.

3. Kjo Marrëveshje ka si qëllim të vetëm ndihmën reciproke administrative ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk i japin të drejtë ndonjë personi privat të marrë, vendosë ose përjashtojë ndonjë fakt apo të pengojë ekzekutimin e kërkesës.

KAPITULLI III

Fusha që mbulon asistencën

Neni 3

1. Administratat Doganore do t'i japin njëra-tjetrës mbi bazën e kërkesës dhe me iniciativën e tyre personale, informacion dhe inteligjencë në ndihmë të zbatimit të rregullt të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, zbulimin dhe luftën kundër shkeljeve doganore.

2. Kur kryen hetime në emër të Administratës Doganore tjetër, Administrata Doganore ose do të veprojnë sikur ato të kryeshin për llogari të vet, ose me kërkesën e ndonjë autoriteti tjetër të asaj Palë Kontraktuese.

Neni 4

1. Mbi bazën e kërkesës, Administrata Doganore të cilës i bëhet ajo kërkesë do të furnizojë të gjithë informacionin mbi legjislacionin dhe procedurat doganore që aplikohen nga ajo Palë Kontraktuese dhe që lidhen me hetimet për shkelje doganore.

2. Secila nga Palët Kontraktuese do të komunikojë, ose me kërkesë, ose me iniciativën e saj personale çdo informacion disponibël që lidhet me :

- a) teknikat e reja për detyrimin e zbatimit të ligjit të provuara si efektive;
- b) tendencat e reja, mjetet dhe metodat për kryerjen e shkeljeve doganore.

KAPITULLI IV **Shembuj të asistencës**

Neni 5

Mbi bazën e kërkesës, administrata që i drejtohet ajo kërkesë në veçanti do t'i japë administratës kërkuese informacionin që vijon :

- a) nëse mallrat e eksportuar, të importuara në territorin doganor të Palës Kontraktuese që bën kërkesën, ishin eksportuar ligjërisht nga territori doganor i Palës Kontraktuese të kërkuar;
- b) nëse mallrat e eksportuara nga territori doganor i Palës Kontraktuese që bën kërkesë janë importuar ligjërisht në territorin doganor të Palës Kontraktuese, që i bëhet kërkesë dhe, në qoftë se ekziston, në cilën procedurë doganore ishin vendosur mallrat në fjalë.

Neni 6

Në qoftë se në kuadrin e dispozitave ligjore dhe rregullatore, Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do të këmbëjnë ndonjë informacion (mbi bazën e një kërkesë dhe më pas përpara hetimit, në qoftë se është e nevojshme) që i aftëson për të siguruar se detyrimet doganore dhe taksat mbledhen në mënyrë korrekte, ky informacion do të jetë veçanërisht i tillë që të lehtësojë :

- a) përcaktimin e vlerës së taksueshme, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave;
- b) zbatimin e dispozitave që lidhen me ndalimet, kufizimet dhe kontrollet.

Neni 7

Mbi bazën e kërkesës, Administrata që i bëhet kjo kërkesë furnizon informacion dhe inteligjencë mbi, si dhe drejton survejime për :

- a) personat e njohur nga administrata që bën kërkesë, si kryerës të shkeljeve doganore apo të dyshuar si të tillë, në veçanti, për ata persona që lëvizin për në dhe nga territori doganor i Palës Kontraktuese që i bëhet kërkesa;
- b) mallrat, në transport apo në ruajtje, që njoftohen nga administrata doganore kërkuese se ka arsye të dyshohet për trafik të jashtëligjshëm drejt territorit doganor të Palës Kontraktuese që bën kërkesën;
- c) mjetet e transportit për të cilat administratat që bën kërkesën dyshon se përdoren për të kryer shkelje doganore në territorin doganor të Palës tjetër Kontraktuese;
- d) ambientet që administrata doganore që bën kërkesën dyshon se përdoren për të kryer shkelje doganore në territorin doganor të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 8

1. Administratat Doganore do t'i sigurojnë njëra-tjetrës, me kërkesë ose me iniciativën e tyre personale, informacion dhe inteligjencë për transaksionet e kryera apo të planifikuara për t'u kryer, të cilat përbëjnë apo duket se përbëjnë shkelje doganore.
2. Në rastet serioze që përbëjnë dëmtime thelbësore për ekonominë, shëndetin publik, sigurinë publike apo ndonjë interes tjetër jetësor të njëjës nga Palët Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, sipas mundësisë, jep informacion dhe inteligjencë me iniciativën e saj.

Neni 9

Administratat Doganore:

- a) do të ndihmojnë njëra-tjetrën në drejtim të ekzekutimit të masave tranzicionale dhe proceduriale, përfshi kapjen, ngrirjen ose dorëzimin e pasurive;

b) do të asistojnë në lidhje me rregullimin e pasurive të përfituara apo të instrumentalizuara, si rezultat i asistencës së parashikuar në këtë Marrëveshje në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe dispozitat administrative të Palës Kontraktuese mbi kontrollin e pasurive të përfituara apo të instrumentalizuara.

KAPITULLI V **Dokumentet dhe Inteligjencia**

Neni 10

1. Dokumentet origjinale do të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet e vërtetuara apo autentike do të jenë të pamjaftueshme dhe do të kthehen sapo të jetë e mundur më shpejt. Të drejtat e administratës që bën kërkesën apo të palëve të treta që lidhen me këtë çështje nuk do të merren parasysh.
2. Çdo dokument apo informacion inteligjent që do të këmbëhet sipas kësaj Marrëveshjeje do të shoqërohet me informacion të plotë që lidhet me përdorimin apo mospërdorimin e tij.

KAPITULLI VI **Ekspertët dhe dëshmitarët**

Neni 11

Sipas kërkesës së Palës Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese autorizon sa herë që është e mundur, nëpunësit e saj për të deponuar si dëshmitarë apo ekspertë në proceset gjyqësore apo procedimet administrative për shkeljet doganore që gjykohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, si dhe për të prodhuar fakte, udhëzues dhe dokumente të tjera, apo kopje të vërtetuara të këtyre të fundit, konform nevojës gjatë procedimeve të sipërpërmendura. Urdhri për paraqitje, në veçanti, përcakton çështjen gjyqësore, si dhe statusin me të cilin nëpunësi thirret të dëshmojë. Administrata Doganore e Palës Kontraktuese, që pranon kërkesën, shënon në autorizimin që lëshon, në mënyrë specifike në qoftë se kërkohet, kufijtë brenda të cilëve mund të dëshmojnë agjentët e saj.

KAPITULLI VII Komunikimi i kërkesës

Neni 12

1. Asistenca sipas kësaj Marrëveshjeje do të këmbëhet direkt ndërmjet Administratave Doganore.
2. Kërkesat për asistencë, sipas kësaj marrëveshjeje, bëhen me shkrim dhe shoqërohen nga çdo dokument që mendohet se është i nevojshëm. Kur rrethanat e imponojnë, mund të bëhet edhe kërkesë verbale. Në këtë rast këto kërkesa duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.
3. Kërkesat e bëra në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, do të përmbajnë detajet që vijojnë:
 - a) Administratën që bën kërkesën;
 - b) objektin dhe arsyen pse bëhet kjo kërkesë;
 - c) emrat dhe adresat e palëve të përfshira me atë procedurë në qoftë se njihen.
4. Kërkesa nga secila Administratë Doganore, që lidhet menjë procedim të caktuar, do të përmbushet në përputhje dhe në respektim me legjislacionin kombëtar dhe procedurat administrative të Palës Kontraktuese që i bëhet kjo kërkesë.
5. Palë nga Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me paragrafin 2 të nenit 19 të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI VIII **Ekzekutimi i kërkesës**

Neni 13

1. Në qoftë se administrata, të cilës i paraqitet një kërkesë nuk i ka dokumentet ose informacionin që kërkohet, në përputhje me legjislacionin kombëtar të saj dhe procedurave administrative ose do të:
 - a) do të fillojë hetimin për të përfutur dokumentet në fjalë ; ose
 - b) do t'ia transmetojë kërkesën agjencisë që mbulon atë fushë; ose
 - c) do të njoftojë se cilat autoritete kanë lidhje me këtë çështje.

2. Çdo hetim i kryer sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të përfshijë marrjen e deklaratave (pohimeve) nga personat nga të cilët informacioni nxirret në lidhje me shkeljen doganore dhe nga dëshmitarët dhe ekspertët.

Neni 14

1. Në kërkesën me shkrim, nëpunësit e caktuar enkas nga administrata që e bën atë kërkesë, me autorizimin e administratës së cilës i drejtohet kërkesa dhe konform kushteve që mund të imponojë kjo e fundit, mundet që me qëllim hetimin e një shkeljeje doganore:

a) të konsultohen, në zyrat e administratës së cilës i drejtohet kërkesa, me dokumentet, regjistrat dhe të dhënat e tjera që u interesojnë për të nxjerrë ndonjë informacion në drejtim të shkeljes doganore;

b) të marrin kopje të dokumenteve, regjistrave dhe të dhënave të tjera që kanë lidhje me atë shkelje doganore;

c) të jenë të pranishëm gjatë hetimit që udhëhiqet nga administrata, të cilës i dërgohet kërkesa, në territorin doganor të palës kontraktuese që i bëhet kërkesë dhe që lidhet me administratën që bën kërkesën. 2. Kur nëpunësit e palës që bën kërkesën paraqiten, sipas rrethanave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në territorin e palës tjetër kontraktuese duhet që gjatë gjithë kohës të paraqesin prova të kapacitetit të tyre zyrtar. 3. Gjatë kohës që janë atje, ata duhet të gëzojnë të njëjtën mbrojtje me atë që ju garantohet nëpunësve doganorë të palës tjetër kontraktuese, në përputhje me ligjet në fuqi në atë vend dhe të jenë të përgjegjshëm për çdo shkelje që mund të bëjnë.

KAPITULLI IX

Përdorimi i informacionit dhe dokumentacionit si dhe mbrojtja e tyre

Neni 15

1. Informacioni, komunikimet dhe dokumentacioni i marrë në kuadrin e asistencës administrative, mund të përdoren në procedimet civile, penale dhe administrative konform kushteve të përcaktuara nga legjislacioni respektiv i aplikueshëm në fuqi dhe vetëm për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

2. Një informacion, komunikim apo dokumentacion i tillë, mund t'i ekspozohet organeve qeveritare të ndryshme nga ato të përmendura në këtë marrëveshje, vetëm në qoftë se është dhënë leje e veçantë nga Administrata Doganore që e ka dhënë atë dhe me kusht që legjislacioni i brendshëm i Administratës Doganore marrëse nuk e ndalon atë lloj komunikimi.

3. Megjithatë, si pasojë e detyrimeve që i linden Italisë si vend i BE, dispozitat që përmenden në paragrafet paraardhës nuk ndalojnë që informacioni, komunikimi dhe dokumentet e marra, në qoftë se kërkohen, të mund t'i kalohen Komisionit Europian dhe shteteve të tjera anëtare të BE-së.

4. Informacioni, komunikimi dhe dokumentet në dispozicion të Administratës Doganore të Palës Kontraktuese kërkuese, do të gëzojnë në zbatim të kësaj marrëveshjeje, të njëjtën mbrojtje që sigurohet nga ligjet kombëtare të palës kontraktuese të lartpërmendur për dokumentacionin dhe informacionin e së njëjtës natyrë.

Neni 16

Kur sipas kësaj marrëveshjeje këmbehen të dhëna personale, palët kontraktuese duhet të sigurojnë një standard për mbrojtjen e të dhënave të paktën të njehsueshme me atë që rezulton nga zbatimi i parimeve të caktuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje, i cili është pjesë integrale e marrëveshjes.

KAPITULLI X Përjashtimet

Neni 17

1. Në rastet kur asistenca sipas kësaj Marrëveshjeje bie në kundërshtim me sovranitetin, sigurimin, politikën publike ose interesa të tjera themelore të palës kontraktuese, apo mund të përbëjë një shkelje të sekretit industrial, tregtar ose profesional, apo të mos përputhet me dispozitat ligjore kombëtare dhe administrative të asaj pale, asistenca mund të refuzohet.

2. Në qoftë se administrata që bën kërkesë nuk do të ishte në gjendje t'i përgjigjej kërkesës së të njëjtit karakter të bërë nga pala, të cilës i paraqitet kërkesa, e para duhet të tërheqë vëmendjen për një fakt të tillë në kërkesën e saj. Përbushja e një kërkesë të këtij lloji është në dëshirën e administratës që i drejtohet një kërkesë e tillë.

3. Asistenca mund të shtyhet nga administrata të cilës i kërkohet ajo, në kushtet që dhënia e saj do të interferonte me një investigim në proces, procedurë apo gjykim. Në një rast të tillë, administrata së cilës i drejtohet kërkesa për asistencë konsultohet me administratën që bën kërkesë për të përcaktuar nëse asistenca në fjalë mund të jepet apo jo në kushtet apo afatin që kërkon administrata kërkuese.

4. Në rastet kur dhënia e asistencës mohohet apo shtyhet duhet të jepen edhe arsyet për shtyrjen ose refuzimin e saj.

KAPITULLI XI Shpenzimet

Neni 18

1. Administratat Doganore nuk do të pranojnë asnjë pretendim për shlyerje të shpenzimeve që lidhen me ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje, përjashto shpenzimet dhe dietat e paguara për ekspertët dhe dëshmitarët, si dhe shpenzimet për përkthim e interpretim, për personat që nuk janë nëpunës shtetërorë, të cilët do të përballohen nga pala që bën kërkesën.

2. Në qoftë se për ekzekutimin e një kërkesë kërkohen shpenzime të rëndësishme dhe të natyrës së jashtëzakonshme, Palët kontraktuese konsultohen për të përcaktuar kushtet dhe afatet sipas së cilave do të përmbushet kërkesa si dhe mënyrën se si do të përballohen shpenzimet.

KAPITULLI XII

Zbatimi i Marrëveshjes

Neni 19

1. Administratat Doganore do të marrin masa me qëllim që nëpunësit e tyre përgjegjës për hetimin apo luftën kundër shkeljeve doganore të kenë lidhje direkte dhe personale me njëri-tjetrin.

2. Administrata Doganore vendos mbi rregullimet e detajuara që lidhen me vënien në zbatim të kësaj marrëveshjeje.

3. Do të krijohet një Komision i Përbashkët Italo-Shqiptar, në përbërje të të cilit do të jenë drejtorët e përgjithshëm të Doganave të të dy shteteve kontraktuese ose përfaqësuesit e tyre, i asistuar edhe nga ekspertë, që do të takohet sa herë që ta paraqesë nevoja, me kërkesën e njëjës nga administratat, me qëllim që të realizohet mbikqyrja e zhvillimeve sipas kësaj marrëveshjeje, si dhe të gjenden zgjidhjet e duhura për problemet që mund të dalin.

4. Konfliktet për të cilat nuk do të gjendet zgjidhje miqësore do të fiksohen me anë të kanaleve diplomatike.

KAPITULLI XIII

Aplikimi

Neni 20

Kjo Marrëveshje do të zbatohet brenda territoreve doganore të të dy palëve kontraktuese, në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative kombëtare respektive.

KAPITULLI XIV

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Neni 21

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë nga dita e marrjes së njoftimit të dytë, prej dy njoftimeve, me të cilat palët kontraktuese njoftojnë zyrtarisht njëra-tjetrën se janë përmbushur kërkesat e brendshme respektive për ratifikim të kësaj marrëveshjeje.

Neni 22

Kjo Marrëveshje është menduar të jetë e pakufizuar në kohë, por secila nga palët kontraktuese mund ta përfundojë në çdo kohë atë me anë të kanaleve diplomatike. Përfundimi hyn në fuqi pas tre muajve që i njoftohet palës tjetër kontraktuese.

Neni 23

Palët Kontraktuese do të takohen me qëllim revizionimin/rishikimin e kësaj Marrëveshjeje mbi bazë të kërkesës, ose në fund të 5 vjetëve nga data e hyrjes së Marrëveshjes në fuqi, në qoftë se nuk njoftojnë nëra-tjetrën me shkrim se një rishikim i tillë është i panevojshëm. Dëshmitarë përsa më sipër, përfaqësuesit e autorizuar sipas rregullave nga qeveritë përkatëse nënshkruajnë këtë Marrëveshje. Bërë në Tiranë, më 12 mars 1998, në dy origjinale, secila në gjuhët shqip, italisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast divergjence për shkak të përkthimit do të mbizotërojë teksti në anglisht.

PËR QEVERINË E PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË REPUBLIKËS SË ITALISË ANEKS PARIMET BAZË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

1. Të dhëna personale që i nënshtrohen përpunimit automatik do të jenë ato që:

- a) merren dhe procedohen me ndershmëri dhe në mënyrë ligjore;
- b) ruhen për qëllime të caktuara dhe të ligjshme dhe nuk përdoren në ndonjë mënyrë që nuk përputhet me këtë qëllim;
- c) janë adekuate, me lidhje dhe jo ekstreme me qëllimet për të cilat janë ruajtur,
- d) janë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të rinovuara;
- e) ruhen në formën që lejon identifikimin e të dhënave me kusht por jo më gjatë se sa kërkohet për qëllimet për të cilat ruhen ato të dhëna.

2. Të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike apo fetare ose besime të ndryshme, si dhe të dhënat personale që lidhen me shëndetin apo jetën seksuale, mund të përpunohen në mënyrë automatike në qoftë se ligjet e brendshme nuk garantojnë sigurinë e duhur. E njëjta gjë aplikohet edhe për të dhënat personale që i referohen bindjeve kriminale.

3. Duhet të merren masat e duhura të sigurimit për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave, përkundrejt ndonjë shkatërrimi të paautorizuar apo humbje aksidentale, si dhe kundër futjes së paautorizuar tek ato, ndryshimit apo publikimit të tyre.

4. Çdo person duhet të jetë i aftë të:

- a) ketë/krijojë një skedar të kompjuterizuar të të dhënave personale, qëllimet kryesore që ka ky skedar, si dhe identitetin dhe vendqëndrimin e rregullt apo vendndodhjen kryesore të kontrolluesit të këtij skedari;
- b) të përftojë në intervale të arsyeshme dhe vonesë të panevojshme apo shpenzime, konfirmimin se nëse të dhënat personale që lidhen me atë janë ruajtur në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave dhe se këto të dhëna i komunikohen atij në një formë të lexueshme;
- c) të përftojë, sipas rastit, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave të tilla në qoftë se ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm që bëjnë fjalë për parimet bazë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Aneksi.

5.1. Nuk lejohet përjashtim nga pikat 1, 2 dhe 4 të këtij Aneksi, me përjashtim brenda kufijve të përcaktuara në këtë pikë.

5.2. Shmangia nga dispozitat e pikave 1, 2 dhe 4 të këtij Aneksi lejohet vetëm atëherë kur një shmangie e tillë parashikohet me ligj të Palës Kontraktuese dhe përbën një masë të domosdoshme për një shoqëri demokratike dhe është në interes të:

- a) mbrojtjes së sigurisë shtetërore, qetësisë publike, interesave monetare të shtetit ose dënimin e shkeljeve kriminale;
- b) mbrojtjen e të dhënave që kufizohen nga e drejta dhe liria e të tjerëve;

5.3. Kufizimi për ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në pikën 4, paragrafet b), c) dhe d) të këtij Aneksi mund të sigurohen me ligj në rastin e skedarëve të kompjuterizuar të të dhënave statistikore apo të dhënave për kërkime shkencore kur aty nuk ka asnjë rrezik të dukshëm për abuzim me problemin e të dhënave.

6. Secila nga Palët Kontraktuese merr përsipër të aplikojë sanksione dhe zgj idhje në rastin e shkeljes të dispozitave të legjislacionit të brendshëm që lidhet me parimet bazë të këtij Aneksi.

7. Asnjë nga dispozitat e këtij Aneksi nuk do të interpretohet si me veprim të kufizuar apo ndryshe, të ndikojë në mundësinë që një Palë Kontraktuese të japë të dhëna me kusht që të gëzojnë një gamë mbrojtjeje më të gjerë se sa ajo që përcaktohet në këtë Aneks.